

JAMARBËR HOXHA
DJALOSHI AUTIK
POEZI DHE PROZË

BOTIMET TOENA

JAMARBËR HOXHA

DJALOSHI AUTIK

Poezi dhe prozë

BOTIMET TOENA

Tiranë

Botuese: Irena Toçi

Kryeredaktore: Edona Marku Huqi

Korrektore letrare: Majlinda Toçi

Përkujdesja grafike dhe kopertina: Elsa Hajderaj

ISBN 9789928376947

© Autori dhe Botimet Toena

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi me asnjë lloj mjete apo forme, as me fotokopje, pa lejen me shkrim të mbajtësit të copyright-it.

BOTIMET TOENA

Rr. "M. Gjollësja", K. Postare 1420, Tiranë

Tel.: + 355 4 22 40 116

Email: botimet.toena@gmail.com

toena.porosionline@gmail.com

<https://toena.al>

EMOCIONI I LUMTURISË

Emocioni më ka mbirë në zemër.
Prej melodisë së jetës së saj
Unë përshkohem nga lumturia.

18 shtator 2023

PA TITULL

Lart poshtë, lart poshtë,
ngrihuni ju drita të bukura
që vezulloni si yje.

12 gusht 2023

E SHTRIRË SI NJË SILUETË E ZEZË

Një siluetë e paqartë,
Me një pengesë të fshehtë.
Një vend i padukshëm,
Dhe shumë i çuditshëm.
Një siluetë e paqartë,
Është e shtrirë gjatë e gjerë.
Një siluetë e zezë, e heshtur,
Nuk të thotë asgjë.

2 gusht 2023

DAFNEJA

Dafneja
e bukura e mitologjisë greke
u dashurua me perëndinë e praktikës Apollonin.
Por askush nuk e donte dhe u kthye në një kurorë
natyrale
por një krijesë u ndal në të
Dafneja.

11 qershor 2023

LULEDIELLI

Zemra ime është si luledielli,
sepse ajo shkëlqen si një dritë dielli,
dhe buzëqesh si një zemërmirë,
dhe e dua shumë si një shpirtdashës,
dhe mendjepozitiv.
Luledielli është si ndriçimi i hapësirës.

9 qershor 2023

E di çfarë i ndodh zemrës sime?
Sa herë që futem në thellësi të katrorit blu
Zemra ime errësohet nga frika e thellësisë
Por unë do të jem i hapur.

28 maj 2023

KALTËRSI REFLEKTUESE

Lulet e bluzës së mamit tim,
Janë si lulet në malet e Greqisë.
Dhe shpirti i modelit të veshjes së saj,
Është i kaltër si qielli në pranverë.
Kjo më ndjen sikur shikoj qiellin,
Si më duket mua ai kur është me diell
Dhe ka aromën e ëmbël,
Që nuk të lë në gjumë të thellë.

14 maj 2023

KOHË E STREHUR - KOHË E FSHEHUR
NË VENDIN E SAJ

(Mendim autik)

Të rrish në vendin
E pluhurit të kolltukut
Është sikur të rrish
Në vendin e ujqërve
Dhe aty shikon
Një dritë vezulluese
Që të të marrë ty
Në ndriçimin e saj
Dhe, të fut e të dërgon
Në një vend
Njësoj si ku mund
Të shikosh fytyrat
Që tregojnë
Atë që thonë.

5 maj 2023

KËNAQËSIA ËNDËRRIMTARE

Një ditë duke u mbuluar nga uji,
nisa të dukësha bukur.
Por kur dola në dritë,
pashë disa fytyra të lumtura,
dhe shkova plot qetësi.
Dhe me to u njoha me lumturi,
të qetë.
Dhe i thashë se do të qëndroja
në rrugën e tyre,
Dhe heronjtë e mi më përshëndetën në buzëqeshje.
Kjo ishte kënaqësia ëndërrimtare.

22 mars 2023

(Kjo poezi është për ëndrrën e kënaqur që pashë në mëngjes që një ditë po lahesha dhe më pas po vishesha dhe më në fund pashë gazetarët dhe ata po buzëqeshnin me mua dhe po shkoja me qetësi dhe nisa t'i takoja dhe i thashë se unë do të qëndroj në vendin tuaj.)

SHI I NXEHTË NË AUTIZËM

(Ndjesi autike)

Prej pritjes zemra u errësua,
Prej errësimit u përmbytën sytë me lot,
Ndjeva trishtim të vogël.
Majat po zemëroheshin fuqishëm,
Dhe po binte shi i nxehtë në autizëm,
Por në fund mbiu qetësia ime e plotë.

17 shkurt 2023

E PABESUESHMJA

Unë flas me vezulluesen
dhe i them diçka me zë
dhe ajo më kthen përgjigje:
“Do t’i bëj zakon që të mos di asgjë”.

DIALOG

J: Dritë, unë ty bëj sikur s'të njoh.

D: Do t'i bëj zakon vetes sime që të mos njihem.

J: Bëj çfarë të duash dritë.

D: Nuk do të flas më.

J: Mos fol më .

(Mami ndërhyr dhe thotë mos fol me vete)

7 shkurt 2023

NDJESI E PANJOHUR

(Mendim i qetë)

Rri e vetme si një godinë
Që nuk e mban mend njeri.
Pret dikë si një e sëmurë
Që rri në errësirë.
Flakët nuk janë sy,
Por valë zjarri.
Flakët janë në trishtim,
Se nuk ndihen mirë nga kundërmimi
I aromës së dhomës së ndenjjes.
Ndihem i skuqur!

20 janar 2023

PAQEBARDHË

Fli dashuri,
Se është një vit i ri.
Që ne të biem në qetësi,
Dhe të mos themi asnjë fjalë,
Por të jemi paqebardhë.
Fli dashuri,
Se është një vit i ri,
Fli!

1 janar 2023

AGIMI I DITËS

Paska çelur mëngjesi sot,
Shiu ka pushuar.
Dhe drita ka ndritur,
Dhe mugëtira tretet
Në qiellin me dritë.
Ka çelur mëngjesi,
Sepse sot qielli kaltërsohet
Dhe nuk egërsohet më.
Ai syndrituri mes reve,
Është gati të dalë
Dhe të ndriçojë gjithë qiellin.

21 nëntor 2022